

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët Valdete Daka, kryetare e kolegjit, Agim Maliqi dhe Emine Mustafa, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të dënuarit P.K., për shkak të veprës penale vrasja në tentativë, nga neni 178 të KPRK-së, duke vendosur përkitazi me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitur nga mbrojtësi i të dënuarit, av. G.H., kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda PKR.nr.697/2015 të datës 12.02.2018 dhe aktgjyqimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PAKR.nr.183/2018 të datës 24.05.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur, më 06 nëntor 2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e mbrojtësit të të dënuarit P.K., e paraqitur kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti për Krime të Rënda PKR.nr.697/2015 të datës 12.02.2018 dhe aktgjyqimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PAKR.nr.183/2018 të datës 24.05.2018.

A r s y e t i m

Vendimi i Gjykatës Themelore

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda, me aktgjykimin PKR.nr. 697/2015 të datës 12.02.2018, të dënuarin P.K. e ka shpallur fajtor për veprën penale vrasja në tentativë nga neni 178 të KPRK-së dhe e ka gjykuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 3 (tri) vite, në të cilin dënim i është llogaritur koha e kaluar në arrest shtëpiak prej datës 14.11.2015 deri me datë 14.12.2016. I është konfiskuar mjeti – thika me të cilin është kryer vepra penale si dhe është obliguar në pagesën e paushallit gjyqësor në shumë prej 50

(pesëdhjetë) €. I dëmtuari për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest civil.

Me të njëjtin aktgjykim i dënuari A.S. është shpallur fajtor për veprën penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par.2 të KPRK-së dhe është gjykuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në periudhën prej 1 (një) viti nuk kryen vepër tjetër penale, kurse i dënuari A.K është shpallur fajtor për veprën penale pjesëmarrja në rrahje nga neni 190 par.1 të KPRK-së dhe është gjykuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 3 (tre) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në periudhën prej 1 (një) viti nuk kryen vepër tjetër penale. Janë obliguar në pagesën e paushallit gjyqësor në shumë prej nga 30 €.

Vendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës

Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktgjykimin PAKR.nr.183/2018 të datës 24.05.2018, ka refuzuar si të pabazuara ankesën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë dhe mbrojtësit të të dënuarit P.K. dhe e ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë

Kundër këtyre aktgjykimeve kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit, av. G.H. nga G., për shkak të vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës ta aprovojë si të bazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, të ulë dënimin e shqiptuar ose çështjen ta kthej në rigjykim dhe rivendosje vetëm sa i përket lartësisë së dënimit.

Mendimi i Prokurorit të Shtetit

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit e Kosovës, me shkresën KMLP.nr.168/2018 e datës 26.09.2018, ka propozuar që kërkesa të refuzohet si e pabazuar.

Pretendimet e paraqitura në kërkesë

Në kërkesë mbrojtësi i të dënuarit thekson se dënimi i shqiptuar me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë dhe i vërtetuar nga gjykata e shkallës së dytë nuk ka pasur vlerësim real përkitazi me llojin dhe lartësinë e dënimit të shqiptuar. Edhe pse gjykata e shkallës së parë ka marrë parasysh disa nga rrethanat lehtësuese për vendimin e shqiptuar, megjithatë nuk ka marrë si rrethanë veçanërisht lehtësuese faktin se i dënuari ditën kritike ka qenë afër shtëpisë së tij duke punuar dhe aty kanë shkuar personat e tjerë përkatësisht të dëmtuarit e që pas mosmarrëveshjes verbale mes tyre ka ardhur deri te përlëshja, të cilin e kanë filluar të dëmtuarit.

Më tutje pretendohet se përkundër faktit se gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e shkallës së dytë kanë vërtetuar se i dënuari nuk i ka parapri ngjarjes, përkundër këtij konstatimi kanë shqiptuar dënim efektiv dhe mjaft të lartë, kurse mes rrethanave rënduese kanë çmuar edhe faktin se i dëmtuari është i moshës së re, ashtu që bazuar në arsyetimet e theksuara në mënyrë të gabuar kanë vlerësuar rrethanat që kanë ndikuar në llojin dhe lartësinë e dënimit dhe në këtë mënyrë gabimisht është aplikuar ligji në dëm të të dënuarit.

Gjetjet e Gjykatës Supreme të Kosovës

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të KPPK-së dhe pas vlerësimit të pretendimeve në kërkesë, gjeti se:

kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë nuk është e bazuar.

Gjykata e shkallës së parë drejt ka zbatuar ligjin penal dhe të dënuarit i ka shqiptuar dënimin e përcaktuar brenda kornizave të minimumit dhe maksimumit të dënimit të përcaktuar dhe atë duke u bazuar në mënyrën dhe rrethanat e kryerjes së kësaj vepre penale dhe ka çmuar të gjitha rrethanat përkitazi me llojin dhe lartësinë e dënimit.

Gjykata Supreme e Kosovës, konstatojë se konform dispozitës se nenit 385 par.5 të KPPK, kur është fjala për vendimin për dënim, shkelje e ligjit penal bëhet kur në marrjen e vendimit për dënim, dënimi alternativ, vërejtja gjyqësore ose në marrjen e vendimit për masën e trajtimit të

detyrueshëm për rehabilitim apo për konfiskim të dobisë pasurore të fituar me veprën penale, gjykata ka tejkaluar kompetencat ligjore.

Andaj, në rastin konkret janë vlerësuar të gjitha rrethanat dhe me këtë drejt është aplikuar ligji penal, ashtu që pretendimi i mbrojtësit të të dënuarit i paraqitur në kërkesë se aktgjykimi është përfshirë në shkelje të ligjit penal nuk është i bazuar.

Nga sa u parashtrua më lartë e në kuptim të nenit 437 par.1 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.244/2018, më 06 nëntor 2018

Procesmbajtësi,
Bujar Balaj

Kryetarja e kolegjit,
Valdete Daka